

Propozimet për ndryshim te Nenit 19

19.6 Pasi te konstatohet qe konsumatori ka bere shkelje nga Nenit 5 i kësaj rregulle (shfrytëzim i paautorizuar, vjedhje dhe abuzim me njehsorin); ndërmarrja e energjisë do te ndërmarre këto veprime

- (a) Do te përgatis një raport te shkruar ne te cilin përfshihen dy elemente:
 - (i) Raporti përshkruan mënyrën se si konsumatori është duke marre energji ne mënyrë te paautorizuar (ose ka marre), vjedh ose abuzon me njehsorin –piken matëse.
 - (ii) Regjistron te dhënat teknike te pikës matëse, kablove furnizuese dhe pajisjeve tjera teknike, dhe
 - (iii) Njoftimi lidhur me pasojat nëse ai rikycet pa lejen e ndërmarres se energjisë ose ne kundërshtim me këto rregullat, duke përfshirë edhe sanksionet e mundshme kriminale.

Një kopje te raportit te shkruar duhet t'i lihet konsumatorit. Ne rast se konsumatori mungon ose nuk e pranon raportin , kopja duhet t'i lihet ne pronën e konsumatorit

- (b) Ben fotografimin e te dhënave qe te mbështes mënyrën e abuzimit te fakteve ne raportin e shkruar sipas Nenit 19.6 (a)(i) te cekur me larte
- (c) Shkyç konsumatorin nga furnizimi me energji
- (d) Largon te gjitha pajisjet (p.sh. Kablove ose tubave) me te cilat konsumatori ka bere shkeljen e rregullave nga Neni.
- (e) Largon njehsorin ne te cilin vërehen gjurmët e abuzimit dhe manipulimit . Çdo njehsor i larguar duhet te testohet ne përputhje me proceduar e Kodit te Matjes
- (f) Udhëzon konsumatorin për veprimet qe duhet ndërmarre për tu ri kycur ne rrjetin energjetik, orarin te mundshëm për rikycje nëse janë ndërmarre veprime te tilla. Ne ketë aspekt , ndërmarrja e energjisë duhet ta informoj konsumatorin për te drejtat e tij ne kontest te shkyçjes ne përputhje me procedurat e nënvizuara ne Nenin 19.8 te kësaj rregulle.

(g) Përgatite një fature që duhet të përfshijë:

- (i) Një xhirollogari për vlerën financiare të sasisë së energjisë së shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar, vjedhur apo abuzuar me njëhisorin, e cila duhet llogaritur në pajtueshmëri me Kushtet e përgjithshme të Furnizimit
- (ii) Vlera financiare e gjobës vendoset në bazë të “Tabelës së Çmimeve dhe Gjobjave” (shiko Tabelën 1 të kësaj rregulle)

- 19.7 Ndërmarrja e Energjisë është e obliguar që faturat e përgatitura sipas Nenit 19.6 i). t’ia dërgoi konsumatorit në afatin sa më të shkurtër, e më së largu deri në dy (2) ditë kalendarik pas ditës së ekzekutimit të shkyçjes. Ndërmarrja e Energjisë duhet ose postoj faturën në adresën e konsumatorit që është paraqitur në regjistrat e ndërmarrjes energjetike ose me dorëzim fizik në atë adresë .
- 19.8 Konsumatori ka të drejtë që të kundërshtoj faturën për rikthim të energjisë në bazë të nenit 19.6. i) por kundërshtimet e tij duhet të paraqes në mënyrë të shkruar tek ndërmarrja e energjisë në afat prej (7) ditësh kalendarik pas marrjes së faturës.
- 19.9. Nëse konsumatori konteston faturën për rikthim të energjisë sipas nenit 19.8 të kësaj rregulle , ndërmarrja e energjisë duhet ta furnizoj me konsumatorin me energji deri sa mere një vendim me shkrim lidhur me refuzimin e paraqitur.
- 19.10 Ndërmarrja e energjisë duhet që të përgatisë një përgjigje me shkrim sipas nenit 19.9 në pajtim me Rregullën për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë në Kosovë dhe duhet t’i dërgohet konsumatorit tek adresa e treguar në regjistrat e ndërmarrjes energjetike
- 19.11 Në afat prej 7 dite pasi që është pranuar vendimi i ndërmarrjes së energjisë ,konsumatori duhet ta paguaj shumën bazuar në vendimin e ndërmarrjes së energjisë ose të shkruaj një ankesë me shkrim në pajtueshmëri me ZRRE-në. Përndryshe konsumatori do të shkyçet.
- 19.12 ZRRE duhet të marrë një vendim me shkrim lidhur me ankesën e dorëzuar nga konsumatori sipas nenit 19.11 brenda 30 ditësh nga dita e pranimit . Për derisa ankesa gjendet në shqyrtim në ZRRE- konsumatori duhet të furnizohet me energji për derisa borxhi i pakontestuar apo ngarkesat tjera paguhet.
- 19.13 Në afat prej 7 ditësh pasi që të dorëzohet vendimi nga ZRRE-ja, konsumatori duhet të paguaj shumën e energjisë së ndërmarrjes sipas vendimit të ZRRE-se ose vendimin e gjykatës ose ai do të shkyçet. Në të kundërtën nëse konsumatori nuk ka kontratë me ndërmarrjen e energjisë ose nuk ka pëlqim teknik, ose nuk ka njëhisor të instaluar nga ndërmarrja ata do të shkyçin.
- 19.14 Përderisa vendimi është duke u shqyrtuar nga gjykata , konsumatori duhet të furnizohet me energji nëse ai ka paguar të gjitha borxhet kontestues apo pagesat tjera dhe depozitën paguhet si vijon:
- (a) për Konsumatorë shtëpiak : 50% e shumës kontestuese
 - (b) për konsumatorët tjerë: 75% e shumës kontestuese
- 19.5 Depozita e sigurisë e paguar sipas Nenit 19.14 duhet të caktohet në një xhirollogari garancioni në një institucion financiar që duhet të përcaktohet nga ZRrE dhe t’iu nënshtrohet udhëzimeve të vendosura nga ZRrE.

- 19.16 Atëherë kur një vendim i zbatueshëm merret nga gjykata, konsumatori duhet t'ia paguaj ndërmarrjes energjetike shumën e përcaktuar nga gjykata. Nëse shuma që ka borxh konsumatori është më e ulët sesa shuma në xhirollogarinë e garancionit, ndërmarrja e energjisë elektrike do ta pranoj shumën e përcaktuar nga vendimi i gjykatës dhe konsumatori do të pranoj bilancin e pashfrytëzuar, përfshirë kamatën në bilancin e pashfrytëzuar bazuar në shkallën e kamatës të përcaktuar nga ZRrE dhe afatin kohor sa ka qenë garacioni i papaguar. Konsumatori duhet të paguaj ndërmarrjes së energjisë elektrike shumën e përcaktuar nga vendimi i gjykatës më pak sesa bilanci në xhirollogarinë e garancionit. Nëse konsumatori nuk ia paguan atë shumë ndërmarrjes së energjisë elektrike brenda tre (3) ditëve të punës, ata do të shkyçen. Përveç kësaj, nëse gjykata ka marrë vendim që konsumatori ka kryer kundërvajtje sipas Nenit 19.6 të këtyre Rregulloreve, konsumatori gjithashtu duhet të paguaj gjobën e përcaktuar nga Lista e Çmimeve për Gjjoba dhe Kthimin e Humbjeve në Buxhetin Qendror të Kosovës.
- 19.17 Duke mos marrë parasysh paragrafin 19.1 ndërmarrja e energjisë elektrike mund të shkyç konsumatorin i cili nuk ka paguar shumën e përcaktuar në paragrafin 19.5.
- 19.18 Më tej, në mënyrë që të shmanget dyshime, asgjë në Nenet 19.6 deri më 19.17 të këtyre Rregulloreve nuk paragjykon të drejtën e ndërmarrjes së energjisë elektrike për t'i shkyçur konsumatorin për çfarëdo arsye tjetër të parapara në këto Rregullore, por as nuk do t'ia merr të drejtën ndërmarrjes së energjisë elektrike që të ndërmerr ndjekje penale ndaj konsumatorit për vjedhjen e energjisë elektrike apo rreth ndonjë kundërvajtje tjetër të përcaktuara me ligj.